



L.nr.15 rr. "Aleksandër Goga"
Spitalle, Durrës
Tel. + 355 052 227 928
Fax. + 355 052 222 887E
E-mail gb4454@gmail.com

KONSULTIMI ME PUBLIKUN

E drejta për informim mbi çështjet e mjedisit në Shqipëri trajtohet si një e drejtë kushtetuese, e veçantë e rregulluar me legjislacionin mbi mjedisin, e garantuar nga neni 56 i Kushtetutës së Shqipërisë, sipas të cilit: "kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij".

Informacion per

Shoqeria "BEBA COSMETIC" Sh.p.k.

Nipt: K81329502N
Adresa: L.nr.15 rr. "Aleksandër Goga", Spitalle, Durrës

Veprimtaria: Industria Kimike
"Prodhimi i kimikateve inorganikë bazë (3).
Prodhim i produkteve farmaceutike baze me
ane te proceseve kimike ose biologjike"
Tipi i lejes: Sipas Shtojcës 1 kjo veprimtari bën pjesë në
lejet e tipit "A". I.D. 4.2 dhe ID 4.5

PUNOI :
Ing. Eneida MARA
Ing. Kimiste Hatixhe BAJRAKTARI
Msc. Odeta ZHEKU
Anila GISHTI

PARATHENIE

Shoqëria **“BEBA COSMETIC” sh.p.k.** me përfaqësuese ligjore zonjën Elsa Balteza, si pjesë e biznesit shqipëtar është ndërmarrja e parë private me karakter higjeno kozmetik që shton përpjekjet për të rritur cilësinë e prodhimeve të tyre duke përsosur teknologjinë. Shoqëria ka filluar veprimtarinë e saj në fushën e prodhimeve të produkteve higjeno-kozmetike, riaktivizimin e industrisë së kozmetikës, nëpërmjet përdorimit të një teknologjie bashkohore me një efektivitet të lartë prodhimi që në vitin 1995.

1. KUADRI LIGJOR

Shqipëria ka legjislacionin e saj të ri mjedisor që bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe përfshin lloje të ndryshme të akteve normative, si ligje të përgjithshme e të veçanta për mjedisin e për përbërës të tij, vendime të Këshillit të Ministrave, urdhra e udhëzime të ministrive, rregullore specifike, norma e standarde etj. Ky legjislacion është përgjithësisht i përqsasur me standardet e BE-së, sepse mbështetet në të njëjtat parime që është mbështetur legjislacioni mjedisor evropian, është hartuar me asistencën e ekspertëve të huaj, si dhe pasqyron përgjithësisht kërkesat e konventave, në të cilat Shqipëria është palë.

- Ligji kuadër Nr. 10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar. Ky ligj eshte plotesisht i perafruar me Direktiven 2004/35/KE te Parlamentit European dhe Keshillit, date 21 Prill 2004 "Mbi pergjegjesite mjedisore, parandalimin dhe riparimin e demeve te mjedisit" te ndryshuar"
- Ligji kuadër në fushën e menaxhimit të mbetjeve nr.10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” ndryshuar me ligjin nr. 156 datë 10.10.2013
- Ligji Nr. 10448, date 14/07/2011 "Per lejet e mjedisit"
- Ligji nr. 26/2017 “Për produktet kozmetike”
- Ligji nr.9587 datë 20.07.2006 “Për biodiversitetin”
- Ligji 8906 datë 06.02.2002 “Për zonat e mbrojtura”

- Ligji nr.9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur”
- Ligji Nr.9774, date 12/07/2007 "Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis"
- Ligji nr.111/2012 datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”
- Ligji nr.162/2014 “Për mbrojtjen e cilsisë së ajrit në mjedis”
- Ligji nr.9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”
- Ligji nr.10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”
- Ligji nr. 10, datë 11. 05. 2009 “Për shëndetin publik”
- Ligji nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”
- Ligji nr.9672, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e Konventës së Aarhusit”
- Ligji nr.9548, date 01.06.2006 "Për aderimin e RSH në protokollin për rregjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve"
- VKM nr.229 datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”
- VKM nr.687 datë 29.07.2015 “Për miratimin për mbajtjen, përditsimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”
- VKM nr.594 datë 10.09.2014 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit”
- VKM nr.803 datë 04.12.2003 “Për miratimin e normave të cilësise së ajrit”
- VKM nr.435 datë 12.09.2002 “Për miratimin e normave të shkakimeve në ajër në RSH”
- VKM nr.692 datë 13.12.2001 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë”
- VKM nr.177, date 31.03.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret.e zonimit të mjediseve ujore pritës”
- VKM Nr 994, datë 2008/07/02, rreth "Opinionit Publik mbi vendimmarrjen mjedisore"

2. Proceset që do të shtohen në impjantin ekzistues

Kjo shoqëri aktualisht ushtron veprimtarinë “Prodhim produkte higjeko-kozmetike” dhe prodhon produkte kozmetike të një cilësie të lartë. Këto artikujt kanë afërsisht 80% të tregut vendas për fëmijë. Subjekti është certifikuar me certifikatë cilësie NR 953 U.N.I – EN-ISO- 9001:2000, për periudhën 2008-2011 dhe ISO 9001-2008 me nr. 1260/10 për periudhën 2011-2013.

Nëpërmjet këtij konsultimi me publikun shoqëria kërkon të bëjë present kërkesën për zgjerimin e aktivitetit të saj duke shtuar gamën dhe kapacitetin e prodhimeve që bëjnë pjesë në produkte farmaceutike, locione, vazelinë, kremëra me veprim të jashtëm. Çdo produkt kozmetik, i bërë i disponueshëm në treg, duhet të jetë i sigurt për shëndetin e njerëzve.

Termet që përdoren:

"Produkt kozmetik" është çdo substancë ose përzierje, e destinuar për t'u vendosur në kontakt me pjesët e jashtme të trupit të njeriut (epidermë, flokë, thonj, buzë etj)

"Substancë" është elementi kimik dhe përbërësit e tij në gjendje natyrore ose të përfutur nëpërmjet procesit të prodhimit, duke përfshirë çdo shtesë të mundshme për të ruajtur qëndrueshmërinë e saj dhe çdo papastërti të ardhur si pasojë e procesit të përdorur, me përjashtim të çdo tretësi, i cili mund të ndahet pa ndikuar në qëndrueshmërinë e substancës ose në ndryshimin e përbërjes së saj.

"Përzierje" është tretësira e përbërë nga dy ose me tepër substanca.

"Ngjyruet" janë substancat, të cilat, veçanërisht ose kryesisht, përdoren për ngjyrosjen e produktit kozmetik, të trupit në tërësi ose pjesëve të tij, nëpërmjet përthithjes ose reflektimit të dritës së dukshme. Prekursorët e ngjyruesve oksidues të flokëve konsiderohen gjithashtu ngjyruet.

"Efekt i padëshirueshëm" është efekti i dëmshëm për shëndetin e njeriut, që i atribuohet përdorimit në kushte normale ose të parashikueshme në mënyrë të arsyeshme të produktit kozmetik.

Kjo veprimtari që do zhvillohet me një numër më të madh produkte të prodhuara dhe me kapacitete të reja (sipas Shtojcës 1 Lejet Mjedisore tipi A” janë të gjithë instalimet me kapacitet pa limit) bën pjesë në **Industria Kimike, I.D. 4.2 dhe ID 4.5 me titull të veprimtarisë, bazuar në shkresën nr.07/1 Prot.**

4

datë 08.01.2018 të AKM Tiranësi dhe Shtojcës 1 (së cilës i referohet shkresa e lartëpërmëndur), “Prodhimi i kimikateve inorganikë bazë (3). Prodhim i produkteve farmaceutike baze me ane te proceseve kimike ose biologjike” leje mjedisore e tipit “A”.

Aktualisht procesi teknologjik i veprimtarisë ekzistuese është proces i secilit produkt që zhvillohet, prodhohet sipas procedurave ditore, planeve ku janë të përcaktuara përgjegjësitë, principet etj. Cdo proces ka dokumentacionin përkatës.

Një ndër produktet e reja janë edhe prodhimi industrial i sapunëve. Me sapunifikimin e yndyrave dhe vajrave krijohen sapunet. Reaksioni i sapunifikimit të yndyrës 2-palmitil-1,3-distearilglicerol me hidroksid natriumi, me çka fitohet glicerol dhe përzierje prej sapuneve: natrium oleat (C17H33COONa) dhe natrium stearat (C15H35COONa). Në përfitimin industrial të sapunëve përcaktohet numër sapunifikimi i yndyrave dhe vajrave, i cili paraqet numër i mg KOH të nevojshëm për sapunifikim të 1 g yndyre ose vaji.

CH OOC C H 2 – – 15 31 | CH OH 2 – | CH OOC C H 2 – – 15 31 | + →
 3NaOH CH OH 2 – | + 15 31 3C H COONa CH OOC C H 2 – – 15 31 CH OH
 2 – Trigliceridi i ac. palmitik glicerinë sapun palmitat natrium.

C15 H31 COOH + NaOH → C15 H31 COONa +H2O

Ac palmitik palmitat natriumi

C 17H35 COOH + KOH →C17 H35 COOK +H2O

Ac. sterik stearat natriumi

Fitimi i sapunit: Matet në erlermaer 5g yndyrë/vaj dhe shtohet 35mL tretje alkoolike në NaOH. Erlermaeri mbyllet me freskues ajrore në ujë të ngrohur në 80°C rreth një orë. Kur yndyra do të tretet tërësisht, d.m.th. se sapunifikimi është i mbaruar. Përzierja e fituar krijohet me NaCl deri në ngopje për t`u ndarë glicerolot prej sapunit. Për të kryer veçimin e sapunit, përzierjen e filtrojmë. Sapunit mund t`i jepet formë, t`i shtohen shtojca për t`ia përmirësuar cilësitë dhe pastaj lihet të thahet. Sapunet i kemi me perberje kaliumi dhe natriumi.

Ndërsa prodhimi i detergjenteve është i ngurtë dhe i lëngshëm, derivate të acidit sulfonik, derivate të acidit fosforik, prodhimi pastash dhëmbësh, kremërash, locionesh.

Hidrogjenimi është një nga proceset më të rëndësishme industriale në prodhimin e sapuneve dhe preparatave vajore industriale i cili kryhet në fazë të lëngët me ndihmën e një katalizatori me bazë nikeli – Raney (aliazh nikeli me një metal tjetër psh me Al i cili para përdorimit largohet me ndihmën e NaOH). Duke ndryshuar kushtet e hidrogjenimit të vajrave bimorë (ekstrakteve bimorë) si temperaturën, shtypjen, prurjen e hidrogjenit dhe veprimtarinë e katalizatorit mund të përfitohen gliceride pjesërisht të hidrogjenuara me temperaturëshkrirjeje dhe plasticitete të dëshiruara. Konkretisht etapate prodhimit të pomadave janë:

- Përzgjedhja e bazës së përshtatshme dhe e lëndës që do të trupëzohet në bazë.
- Përgatitja e lëndës për trupëzim.
- Trupëzimi i lëndës vepruese në bazë.
- Homogjenizimi në havan.
- Kontrolli organoleptik.
- Ambalazhimi i pomadave.
- Ruajtja e pomadave

Procesi teknologjik është bashkësia e proceseve teknologjike të prodhimeve të mëposhtëme:

- Prodhimi i kremërave
- Prodhimi i locioneve
- Prodhime të trajtimit të flokëve
- Prodhimi shamos
- Prodhimi i pudrave

Prodhimi i çdo produkti konsiston në:

- a) Pranimin dhe magazinimin e lëndëve të para dhe ambalazhimit që silllet në fabrikë:
 - Pranimi i lëndëve të para dhe të ambalazhit
 - Evidencimi i kohës së pranimit të lëndëve të para

- Kontrollimi i lëndëve në mënyrë specifike para se të përcillet për në depo dhe raportimi në kohë;
- b) Kontrollin e makinerive të prodhimit para fillimit të prodhimit:
 - Verifikimi i makinave prodhuese nën monitorimin e inxhinierit kimist
 - Plotësimi i formularëve përkatës
 - Verifikimi i makinës prodhuese pas montimit
 - Montimi dhe demontimi i pjesëve të makinave të prodhimit
 - Ruajtja e cilësisë së lëndës së parë në vendin e prodhimit
 - Kontrollimi i parametrave kritikë të ajrit
- c) Asistimi në procesin e prodhimit
 - Përcjellja e një linje të caktuar të prodhimit nën monitorimin e inxhinierit kimist nëse ka nevojë
 - Plotësimi i formularëve të prodhimit sipas orarit përkatës
 - Paketimi sipas nevojës në blistera me fletëpërshkrime nëpër kuti
 - Asistimi në marrjen e mostrave sipas kohës së paraparë, përcjellja e tyre në laborator/prodhim

Një arsye mjaft e rëndësishme është se me përdorimin e preparateve të përgatitura, mënjanohej totalisht përdorimi i konservanteve dhe ngjyruësve. Këto lloj ecipientesh shpesh herë mund të shfaqin probleme alergjike dhe jo pak herë kanë pasur efekte kancerogjene. Kështu që përpara se të blini një krem për bebin tuaj, mendohuni më mirë... Kremrat industrialë kanë një listë të gjatë përbërësish të cilët ju edhe ndoshta nuk i keni dëgjuar ndonjëherë, ndërsa ai i përgatitur nga farmacisti ka vetëm lanolinë, vaj bajame dhe vitaminë E.

Pjesë përbërëse e këtij procesi janë edhe:

- Magazinimi i lëndës së parë
- Pastrimi i lëndëve të para
- Kontrolli vizual
- Etiketimi
- Magazinimi i produktit të gatshëm
- Pastrimi (shplarja e linjës), pastrimi i makinerive dhe shesheve të reparteve

Makineritë dhe pajisjet që përdor kjo shoqëri janë të siguruar nga importi me një teknologji bashkëkohore konform standarteve dhe normave europiane dhe janë të grupuar në:

1. Miksera turbo të këmishuar
2. Miksera pa vakum
3. Dozator pneumatik
4. Makineri ambalazhimi
5. Impiant për trajtimin e ujit
6. Makineri për prodhimin e të kuqit

Makineritë dhe pajisjet që përdoren në këtë veprimtari janë:

- Linjë komplete për dejonizimin dhe sterilizimin e ujit
- Linjë komplete për prodhimin e të kuqit të buzëve
- Linjë komplete për prodhimin e parfumeve dhe aerosoleve
- Linjë automatike për mbushjen e shisheve deri 500ml
- Linjë automatike për mbushjen e solucionëve me densitet të ulët
- Impiant për trajtimin e ajrit
- Makinë mbushjeje 5-300ml, 10-500ml, 10-750ml, 10-1000ml
- Makinë automatike për mbushje mbyllje tubeta alumini
- Makinë automatike për mbushje mbyllje tubeta plastike/për aerosole
- Makinë për konfeksionimin e pudrës
- Makinë mbushjeje automatike për solucionet me viskozitet të lartë
- Makinë për ambalazhim në politilen me ngrohje/për kutitë e kartonit
- Impiant për filtrimin e ujit Rivers Osmoze dhe filtër UË
- Turbo mixer me vakum -09bar me kapacitet 50/150/200litra
- Turbo mixer me vakum -09bar me kapacitet 200litra (10 copë)
- Turbo mixer me vakum -07bar me kapacitet 500litra
- Turbo mixer me vakum -08bar me kapacitet 5litra
- Mixer për përpunime të ftohta me kapacitet 300/800/1000/2000litra
- Mikser inoks 5litër/eksperimentalë (3copë)
- Aparat distilimi
- Rezervuar uji për përgatitje

- Kompresorë dy copë
- Kaldajë teknologjike me kapacitet 600litra/orë
- Printer për shkrimin e lotit dhe datës së skadencës
- Printer për shkrimin e kutive të kartonit
- Printer që printon plastikën/kutitë e kartonit
- Furrë rrudhosje e vogël/e madhe
- Dublikator inoksi i lëndëve të para me kapacitet 100 litër
- Tre tavolina inoksi me mbushës automatik
- Etiketatrice

Makineritë mirëmbahen dhe verifikohet funksionimi i tyre në mënyrë periodike që procesi teknologjik të funksionojë normalisht. Gjithashtu pjesë e paisjeve janë edhe *mjetet matëse*:

- peshore elektronike Europe 4000g AR-Gibertini me saktësi 0.001g
- peshore elektronike Europe 15000g C-Gibertini me saktësi 0.5g
- peshore elektronike EK 3052-5000g LIBRA me saktësi 2g
- peshore VETTA MACCHI-2g Tipo SASP21 me saktësi 1g
- peshore GAZZERI&TESI-10kg me saktësi 5g
- Gascromatograph Siemens AG
- Spectrofotometër Coleman 295E
- ECO SPECOL 10 Carlzais Jena
- Specol për matjen e fluorit në ujë
- Mikroskop
- PH-Metër CG 811 Schott Gera
- PH-Metër Jenco Mod 6091
- Autobyrete ABU 11
- Conductivometër HI 8333
- Dozimetër E-535 Methrom/ E 655 620- Methrom
- Integrator Spectrometër SP 4270
- Integrator HP 3396A Helëett Packard
- Furrë deri në 220⁰C memert

Lënda e parë që përdoret për prodhim bazohet në ekstraktet natyrore të bimëve, ato vijnë të shoqëruara me fletë analizat përkatëse. Lënda e parë analizohet sipas Frmakopeve. Këto janë të konfeksionuara në ambalzhe të përshtatëshme, në mënyrë që të ruajnë cilësinë e tyre për një kohë të caktuar. Kjo kohë është e përcaktuar në etiketën përkatëse.



Të tilla janë Abil 350, acid borik, citrik, stearik, allantoinë, amfisol CB₃, ntiotam, conditioner P₇, dimagnezium fosfat, E.D.T.A. Na₂, E.D.T.A. Na₄, Escallol 557/567, emulgate F, glicerinë, hydrenol D, isopropyl myristate, lanette O/SX, lanoline, magnezium stearate, menthol, metil paraben, permulgin 4200, neobe M₂₀/M₅, zincomadine, emulgine B₁/B₂, ceraphyl 60, ninol 4821, oksid titani/zinku, P.V.P.VA/Ē635, parsol 5000, perla, propyl paraben/glycol, protegin ĒX, rapithix A₆₀, sles, sorbitol, stenol 16-18, stepan SAB₂, synthalen M, tagat S, talk M₂₀, tegin M, tego care 150, tëeen 20, vaj parafinë/bajamesh, vitaminë A/E, ceraphyl 230. Lëndët e para që përdoren janë lëndë të para të industrisë higjieno kozmetike, ato vijnë të shoqëruara me fletë analizat përkatëse.

Këto lëndë janë të konfeksionuara në mbalazhe të përshtatëshme, në mënyrë që të ruajnë cilësinë e tyre për një kohë të caktuar, kohë e cila është përshkruar në etiketën përkatëse. Lëndët e para me origjinë nga industria kimike e kanë datën e skadencës 5 vjet nga data e prodhimit. Kontrolli i datës së skadencës bëhet cdo 6 muaj. Një muaj para datës së skadencës bëhet një analizë dhe nëse kjo e fundit del mirë kësaj lënde i vihet një kartelë “shtyrje afati” ku shënohet afati i ri i skadencës. Nëse analiza del keq lënda eliminohet. Eliminimi bëhet nga magazina, ndërsa mënyra e eliminimit përcaktohet nga laboratorit.

Si lëndë ndihmëse shërben uji i cili merret nga rrjeti i zonës. Gjithashtu uji përdoret edhe për larje/pastrim. Ky ujë nëpërmjet një pompe vjen në tubacionin e linjës me presion 2-3 bar. Kalon në filtër 10mikron F.P. 20/CBS 10-PP 20 që ndrohet cdo 3muaj dhe prej këtej në demineraizator.



Demineralizimi konsiston në heqjen nga uji bruto i të gjithë kripërave të tretura në të në bazë të principit të shkëmbimit të joneve. Demineralizatori përbëhet nga dy kolona të mbushura me rrëshirë jonoshkëmbyese. Si fillim uji kalon nëpër kolonën kationike të rigjeneruar me acid klorhidrik e cila lejon shkëmbimin e kationeve të ujit bruto me jonet hidrogjen:

Rëshirë + Kation \longrightarrow Rrëshirë kation + Jon Hidrogjen




Prej këtij uji bruto kalon nëpër kolonën anionike të rigjeneruar me hidroksid natriumi e cila lejon shkëmbimin e anioneve të ujit bruto me jonet hidroksile:

Rëshirë + anion \longrightarrow Rrëshirë anion + Jon Hidroksil



Jonet e lira hidrogjen në ujin që del nga kolona kationike bashkohen me jonet e lira hidroksile në kolonën anionike duke dhënë ujë të pastër (të demineralizuar).



Ky ujë nëpërmjet tubacionit kalon në një filtër që përdor rrezet ultraviole për pastrimin e mëtejshëm nga ndotja mikrobike. Më pas ky ujë kalon në impiantin e filtrimit të ujit Riversosmoze dhe në këtë moment është ujë i përshtatshëm për prodhimin e produkteve higjeno-kozmetike. Para përdorimit (futjes në proces) merret 1 litër ujë në kazanin e stokimit dhe dërgohet në laborator për kontrollin fiziko-kimik.

Uji i prodhuar në këtë mënyrë kalohet nëpër një aparat me membranë që nxjerrin një ujë 99% të pastër.

Magazinimi i lëndës së parë - Magazina e ruajtjes të lëndës së parë ka ajrim natyral dhe artificial, është e mbrojtur nga rrufetë, ka kanalizime të ujërave dhe ujë të rrjedhshëm për larjen e duarve. Magazinimi i lëndëve të para bëhet sipas llojit dhe sasisë së lëndës dhe mënyrës së konfeksionimit të saj. Kështu lëndët e para të ambalazuara në thasë plastikë apo letre, në bidona plastikë/kuti kartoni magazinohen brënda në magazinën e lëndëve të para ku kushtet e ruajtjes janë optimale përse i përket ruajtjes në errësirë, në vende të freskëta, pa lagështirë. Bëhet një vendosje e tyre në mënyrë të rregullt që të mosdëmtohen këto ambalazhe dhe lënda brënda tyre.

Ndërsa përse i përket lëndëve të para të ambalazuara në fuci plastike/metalike dhe në depozita, vendosja e tyre bëhet në vëndin e caktuar të mbuluar me një

mbrojtëse ndaj dritës dhe nxehtësisë jashtë repartit. Magazinimi bëhet në përputhje me rregullat e ruajtjes së lëndëve dhe të mjedisit.

Pastrimi i lëndëve të para: sipas radhës kronologjike të stokazhit lëndët e para dërgohen në dhomën e peshimit. Pastrohen thasët e letrës me aspirator dhe kutitë e kartonit, ndërsa ambalazhet plastike pastrohen me picetë letre një përdorimshe. Dërgohen përsëri në dhomën e peshimit, peshohen mbyllen dhe magazinohen.

Magazinimi i produktit të gatshëm bëhet në ambiente të ndara kur ka përfunduar plotësisht procesi teknologjik. Produktet janë të ambalazuara, etiketuara, të paketuara në kuti.

Pastrimi (shplarja e linjës), pastrimi i makinerive dhe shesheve të reparteve është operacioni i fundit i ditës që përfaqëson:

Shplarjen e linjës – kazanin e përgatitjes, filtrat, makinat e mbushjes.

Pastrimi i makinave të mbushjes – hiqen vazot, shishet apo tubat e mbetur. Pastrohen me detergjent dhe shplahen në moment të gjitha pjesët e mundëshme të makinave të mbushjes.

Pastrimi i shesheve bëhet me detergjent duke filluar nga salla e përgatitjes, salla e ambalazhit e deri tek koridoret. Këto operacione bëhen edhe në fund të javës duke bërë përveç pastrimeve të mësipërme edhe pastrim me ujë të distiluar dhe dezinfektohen me alkol, cmontohen tubat e silikonit dhe pastrohen me detergjent dhe ujë të rrjedhshëm dhe pastaj me ujë të distiluar.

Prodhimi i nxehtësisë së nevojshme në procesin teknologjik realizohet nga rrjeti elektrik, ndërsa solar përdoren rreth 120 litra në muaj.

“BEBE COSMETIC” sh.p.k prodhon produktet e saj në bazë të Standarteve Shtetërore të mëposhtëme:

STASH 1641-87; Pudra - STASH 3953-87 ;Kremëra - STASH 3956-87 ;Bojë flokësh- STASH 3957-87; locione vajorë - STASH 3958-87 ;Locione - STASH 3959-87; Shampo - STASH 3961-87; I kuq buzësh - STASH 3964-87; Vazelinë e parfumuar.

Produktet që prodhohen-

- Kremëra (Baby krem, krem fytyre, vazelinë, krem flokësh etj)

- Produkte plazhi (mbrojtës dielli trupi për fëmijë/ritur, para/pas plazhit, vaj plazhi etj)
- Produkte për trajtim floku (brilantinë, vaj floku, krem rigjenerant, xhel, bojë floku, balsam etj)
- Produkte shampo (shampo profesionale, shampo fëmijësh, intima etj)
- Produkte pudër (pudër fëmijësh, pudër për këmbë etj)
- Produkte afteshave (perfect, men anly, magic, neutral etj)
- Produkte sapuni (sapun likuid tek, sapun likuid çift)

Markat e produktit të kësaj shoqërie “**BEBA COSMETIC**” sh.p.k janë të regjistruara pranë Drejtorisë së Patentave dhe Markave.